L I G J
Nr.7942, datë 31.5.1995

PËR HYRJEN NË FUQI TË LIGJIT NR.7895, DATË 27.1.1995 "PËR KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal nuk vihet në ekzekutim dhe, në qoftë se ka filluar, ndërpritet ekzekutimi i mëtejshëm i çdo lloj dënimi për veprat penale, të cilat nuk parashikohen më si të tilla nga ky Kod.

Nuk vihen në ekzekutim dhe, në qoftë se ka filluar ndërpritet ekzekutimi i mëtejshëm i dënimeve penale të dhëna për përgatitjen e një krimi, i cili nuk parashikohet si vepër e dënueshme nga dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal.

Neni 2

Personave, të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë për një vepër penale me një masë dënimi më të lartë sesa maksimumi i dënimit që parashikon Kodi i ri Penal për veprën e kryer, i mbetet si dënim ky maksimum.

Personat, të cilët pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal e kanë plotësuar maksimumin e dënimit të parashikuar për veprën e kryer nga ky Kod, lirohen menjëherë.

Neni 3

Lirohen nga vuajtja e mëtejshme e dënimit me burgim të gjithë personat që janë duke e vuajtuar këtë dënim për një vepër penale e cila sipas Kodit Penal dënohet vetëm me gjobë.

Po qe se dënimi i vuajtur gjer atëherë sipas llogaritjes në bazë të nenit 34, paragrafi 7, të Kodit Penal kapërcen masën e gjobës që parashikohet për veprën penale, atëherë dënimi me burgim konsiderohet i kryer.

Në rast se dënimi i vuajtur nuk kapërcen masën e gjobës që parashikohet për veprën penale, pjesa e pavuajtur e dënimit me burgim i kthehet në dënim me gjobë duke zbatuar rregullin e parashikuar nga paragrafi i shtatë i nenit 34 të Kodit Penal.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal refuzohet fillimi i çështjes penale për çdo kallëzim për vepra penale, të cilat nuk parashikohen si të tilla nga Kodi Penal ose nga ligje të veçanta të pashfuqizuara prej tij.

Gjithashtu vendoset pushimi i çështjes penale për çështjet e filluara dhe që ndodhen në ndjekje në organet e ndjekjes penale apo në gjykatë, kur vepra penale nuk parashikohet më si e tillë nga Kodi Penal ose nga ligje të veçanta të pashfuqizuara prej tij.

Neni 5

Lirohen nga vuajtja e mëtejshme e dënimit të gjithë personat e dënuar me çfarëdolloj dënimi për kundërvajtje penale të mbetur në fazën e tentativës.

Neni 6

Lirohen nga vuajtja e mëtejshme e dënimit personat e dënuar me çfarëdolloj dënimi për një vepër, që sipas Kodit Penal apo ligje të veçanta të pashfuqizuara prej tij, përbën kundërvajtje penale, në rast se ditën e hyrjes në fuqi të Kodit Penal janë nën moshën 16 vjeç.

Nuk vihen në zbatim vendimet e gjykatave ndaj personave nën moshën 16 vjeç, që përmbajnë dënime për vepra penale të cilat përbëjnë kundërvajtje penale sipas Kodit Penal apo ligje të veçanta të pashfuqizuara prej tij.

Neni 7

Për personat që janë duke vuajtur dënimin me gjobë ose me burgim, paraburgimi do të llogaritet sipas kritereve të përcaktuara në nenin 57 të Kodit Penal.

Me paraburgim do të kuptohen ditët e qëndruara në ndalim dhe arrestim në burg.

Kur arrestimi nuk është ndërprerë, periudha e paraburgimit do të konsiderohet nga dita e ndalimit e derisa vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë.

Një ditë arresti në shtëpi do të llogaritet me një ditë burgim.

Neni 8

Në rastet kur një person është i dënuar për dy ose më shumë vepra penale sipas rregullave të bashkimit të dënimeve dhe, kur qoftë edhe njërën vepër Kodi Penal nuk e konsideron më të tillë ose cakton një dënim më të butë, çështja shqyrtohet mbi kërkesën e menjëhershme të administratës së burgut nga gjykata e rrethit ku vuhet dënimi, e cila bën bashkimin e dënimeve sipas rregullave të këtij Kodi.

Gjykata e shqyrton çështjen brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës, duke respektuar rregullat e përgjithshme të gjykimit.

Neni 9

Për të përcaktuar nëse vepra penale është ose jo e dënueshme nga Kodi Penal si dhe për efektet e tjera që lidhen me hyrjen në fuqi të Kodit Penal, duhet nisur jo vetëm nga titulli i dispozitës penale të mëparshme dhe asaj të Kodit Penal të ri, por edhe nga përmbajtja e tyre të marra në unitet edhe me dispozitat e tjera të Kodit.

Neni 10

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, në dënimin e vuajtur do të llogariten edhe përfitimet nga amnistia, falja, puna dhe paraburgimi.

Neni 11

Për zbatimin e efekteve që lidhen me hyrjen në fuqi të Kodit Penal ngarkohen sipas përkatësisë organet e prokurorisë, gjykatat, zyrat e përmbarimit dhe Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e administratës së burgjeve).

Personat që kanë pretendime për moszbatim të drejtë të efekteve juridike nga organet e

sipërpërmendura mund t’i drejtohen gjykatës së vendbanimit dhe, në rastet kur vendimi është në ekzekutim, gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal. Gjykatat i shqyrtojnë kërkesat brenda pesë ditëve nga paraqitja e tyre dhe vendosin duke respektuar rregullat e përgjithshme të gjykimit të çështjeve.

Neni 12

Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, shfuqizohen aktet e mëposhtme:

Ligji nr.5591, datë 15.6.1977 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë” si dhe të gjitha shtesat dhe ndryshimet e nevojshme, me përjashtim të neneve 138-160 dhe 217-223 të Pjesës së Posaçme të tij si dhe dispozitave të Pjesës së Përgjithshme që lidhen me zbatimin e këtyre neneve. Shfuqizimi i këtyre neneve do të bëhet me hyrjen në fuqi të Kodit Penal Ushtarak.

Gjithashtu shfuqizohen:

Kreu i shtatë i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare; neni 70 pika 2 e ligjit nr.7599, datë 2.9.1992 “Për kodin doganor të Republikës së Shqipërisë”; neni 15 i ligjit 7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive të tatimeve; dispozitat penale të dekretit nr.7408, datë 31.7.1990 “Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vende publike; neni 12 i dekretit nr.7458, datë 22.1.1991 “Për të drejtën e grevës; paragrafi i pestë i nenit 14 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 “Për armët”; nenet 82 dhe 83 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”; nenet 85 dhe 86 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë Kod.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi së bashku me Kodin e ri Penal të Republikës së Shqipërisë, më 1 qershor 1995.

Shpallur me dekretin nr., datë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha